



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1475/2022

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija – Ymeri dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit/ paditësit Th... C..., me seli në Georgia Usa me përfaqësues Y.S.P, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A.S, avokat nga Prishtina, kundër kundërshtarit të sigurimit/ paditurit “D...” sh.p.k, me seli në magjistralen Gjakovë-Prizren, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit L.M, avokat nga Ferizaj, për shkak të caktimit të masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të masës së sigurimit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.128/2022, i datës 04.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.**27/09/2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa kundërshtarit të masës së sigurisë “D...” sh.p.k, me seli në magjistralen Gjakovë-Prizren dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.128/2022, i datës 04.04.2022.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar e ka aprovuar në tërësi si të bazuar propozimin e palës propozuese Th... C..., me seli në Atlanta, Georgia Usa me përfaqësues Y.S.P, ku dhe ka caktuar masën e sigurisë, ndaj kundërshtarit të sigurimit “D...” sh.p.k, me numër unik identifikues përfaqësuar nga I.B, me seli në Gjakovë, me te cilën është detyruar kundërshtari i sigurimit “D...” shpk me numër unik identifikues përfaqësuar nga I.B qe të ndërprejë të gjitha veprimet që shkelin të drejtën e propozuesit në mbrojtje të markave tregtare në Republikën e Kosovës, ne piken e dyte te dispozitivit ka vendosur që ti ndalohet kundërshtarit të sigurimit D...” shpk me numër unik identifikues përfaqësuar nga I.B, cdo aktivitet që shkel markën tregtare sipas vendimit nr C... të datës 28.10.2021, vendimit nr. F... i datës 07.10.2021 dhe vendimit nr.5901-1/2021 S... të datës 23.02.2013 që përfshinë importimin, eksportimin dhe vendosjen në tregun e Republikës së Kosovës të produkteve që përbejnë shkelje të markës tregtare të propozuesit të masës së përkohshme të sigurisë-bartësit të së drejtës së markës tregtare “Th... C...”, si dhe ka vendosur që të urdhërohet

Dogana e Kosovës të MF ti ndaloje, konfiskoje dhe mos ti lirojë për qarkullim të lirë në tregun e Republikës së Kosovës të gjitha produktet “C...”, “F...”, DHE “ S...”, të importuara nga kundërshtari i sigurimit “D...” shpk apo nga cilado shoqëri tjetër tregtare pa autorizim dhe pëlqimin e propozuesit të masës së përkohshme të sigurisë bartësit të së drejtës së markës së regjistruar tregtare “Th... C...”. Po ashtu është urdhëruar Inspektorati për mbikëqyrjen e tregut të MTI ti konfiskoje dhe largojë nga tregu i Republikës së Kosovës të gjitha produktet “C...”, “F...”, dhe “S...” të importuara nga kundërshtari i sigurimit “D...” shpk, apo nga cilado shoqëri tjetër tregtare pa autorizimin dhe pëlqimin e propozuesit të masës së sigurisë bartësit të së drejtës së markës së regjistruar tregtare “Th... C...”. Ne piken e fundit të dispozitivit është detyruar kundërshtari i sigurimit “D...” shpk me numër unik identifikues 811298274 përfaqësuar nga I.B, Dogana e Kosovës të MF dhe Inspektorati për mbikëqyrjen e tregut të MTI-së të zbatojë në tërësi këtë vendim gjyqësor deri në vendosjen meritorë dhe të formës së plotfuqishme të kësaj çështje gjyqësore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kundërshtari i masës së sigurimit “D...” sh.p.k, me seli në magjistralen Gjakovë - Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar të gjendjes faktik dhe aplikimit të gabuar të ligjit materiale, me propozimin që të hudhet si e pabazuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.128/22 sa i përket lëndës aktvendimit mbi masën e sigurimit në tërësi me të gjitha pikat e aktvendimit si të kundërligjshëm.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - propozuesi i masës së sigurisë propozuesit/ paditësi Th... C..., me seli në Georgia Usa me përfaqësues Y.S.P, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A.S nga Prishtina, me datën 03.03.2022, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit/ padituri “D...” sh.p.k, me seli në magjistralen Gjakovë-Prizren, me propozimin që të aprovohet kërkesa e propozuesit të masës së përkohshme të sigurisë “Th... C...” dhe të caktohet masa e përkohshme e sigurisë ndaj kundërshtarit të masës së sigurisë “D...” shpk, dhe të detyrohet kundërshtari i sigurimit të ndërprejë të gjitha veprimet që shkelin të drejtën e propozuesit në mbrojtjen e markave të regjistruara tregtare në Republikën e Kosovës. Ne seancën e datës 25.03.2022 duke vendosur sipas propozimit të propozuesit, gjykata ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar precizimin e propozuesit të sigurimit për shndërrimin e propozimit të masës së përkohshme siguroese, në masë siguroese.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, me aktvendimin e atakuar, e ka aprovuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, si të bazuar, duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me Nenin 297 par.1 pikat a) dhe b) të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdhe në përfundim se ankesa është e pabazuar, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktvendimit është i kuptueshëm, nuk është kontradiktor me vetvete si dhe nuk ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht në arsyetim të aktvendimit janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe si i tillë mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 181 par.1 e lidhur me nenin 297 të LPK-së dhe nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, e që eventualisht do të mund të përbejë arsye për anulimin e këtij aktvendimi, e po ashtu aktvendimi i atakuar është marrë në përputhje me të drejtën materiale (Ligjin për Marka Tregtare, nenet 8-13) e cila ka qenë në fuqi në kohën e ndodhjes së shkeljes së pretenduar dhe në kohën e marrjes së aktvendimit të atakuar.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Kom.Dh.Shk.II.nr.1475/2022, dt.27.09.2022**

**KRYETARI I KOLEGJIT,
Faton Bajrami, d.v**